

**Gjykata Supreme e Kosovës**  
**AP – Kž. Nr. 365/2009**  
**20 Korrik 2010**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Supreme e Kosovës** në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Norbert Koster, Kryetar i Kolegjit, me Gjyqtarët e EULEX-it Maria Giuliana Civinini dhe Martti Harsia dhe Gjyqtarët e Gjykatës Supreme Emine Kaçiku dhe Emine Mustafa, anëtare të kolegjit, të ndihmuar nga Robert Abercrombie, procesmbajtës,

në lëndën penale kundër të pandehurve

**Bekim Zeka**, nga i ati \_\_\_\_\_, nëna \_\_\_\_\_, i lindur më 1 Dhjetor 1975 në \_\_\_\_\_, komuna e \_\_\_\_\_, adresa e fundit \_\_\_\_\_, Kosovë, Shqiptar i Kosovës, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, ka mbaruar tetë (8) vjet të shkollës fillore, me gjendje ekonomike të dobët,

i mbajtur në paraburgim që nga 27 Korriku 2008,

## **DHE**

**Arben Zeka**, nga i ati \_\_\_\_\_, nëna \_\_\_\_\_, i lindur më 2 Maj 1977 në \_\_\_\_\_, komuna e \_\_\_\_\_, adresa e fundit e banimit \_\_\_\_\_, komuna e \_\_\_\_\_, Kosovë, Shqiptar i Kosovës, i pamartuar, shkollën e mesme të mbaruar, me gjendje ekonomike mesatare,

i mbajtur në paraburgim që nga 28 Korriku 2008,

që të dytë të akuzuar me veprën penale Vrasje të kryer në bashkëpunim për përfitim personal – Neni 30 Paragrafi 2 pika 3 e Ligjit Penal të Kosovës të vitit 1977 (LPK) në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë,

duke vendosur sipas ankesës të paraqitur më datë 25 Shtator 2009 nga Avokati Mbrojtës Abit Asllani në emër të akuzuarit Bekim Zeka dhe sipas ankesës të paraqitur nga Avokati Mbrojtës Zenel Mekaj në emër të Arben Zeka, e datës 14 Shtator 2009, kundër Aktgjykimit P. nr. 268/2008, të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë më 1 Korrik 2009,

në seancën e mbajtur më 20 Korrik 2010, pas këshillimit dhe votimit, lëshon këtë,

## AKTGJYKIM

Ankesat e paraqitura nga Avokati Mbrojtës Abit Asllani në emër të akuzuarit Bekim Zeka dhe Avokatit Mbrojtës Zenel Mekaj në emër të akuzuarit Arben Zeka kundër Aktgjykimit P. Nr. 268/2008, lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë më 1 Korrik 2009, janë refuzuar si të pabaza.

Aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar.

I akuzuari duhet të bart shpenzimet e procedurës së ankesave.

### Arsyetim:

#### I. Historia Procedurale

Dikur në fund të Qershorit 1999, nuk dihet dita, është zhdukur E., shofer taksie nga Peja. Më vonë, ai u gjet i vdekur, i vrarë me një plumb që ishte shkrepur në te nga prapa në qafë.

Hetimi penale kundër dy të pandehurve ishte iniciuar më 29 Korrik 2008 bazuar në deklaratën e dëshmitarit S. i cili kishte shkuar në polici me qëllim të raportimit të vjedhjes së veturës private të tij, gjoja të kryer nga djemtë e tij Bekimi dhe F.. Në këtë kontest ai po ashtu i kishte treguar policisë se djemtë e tij Bekimi dhe F.u kishin plaçkitur dhe vrarë një shofer taksie një vit pas luftës.

Gjatë hetimeve në vazhdim, dyshimi shpejt u përqendrua në Bekim dhe Arben Zekën, të cilët me aktakuzën PP. nr. 259/2008 të datës 17 Tetor 2008 dhe të paraqitur nga Prokurori Publik i Qarkut në Pejë, përfundimisht u akuzuan për veprën penale Vrasje të kryer në bashkëpunim për fitim personal në bazë të Nenit 30 Paragrafi 2 Pika 3 e Ligjit Penal të Kosovës të vitit 1977 (LPK).

Aktakuza ishte konfirmuar nga Gjykata e Qarkut të Pejës, me Aktvendimin KAQ 316/2008 të datës 20 Nëntor 2008.

Duke vepruar sipas kërkesës të paraqitur nga Zëvendës Kryetari i Gjykatës së Qarkut të Pejës, U., më 8 Prill 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve

të EULEX-it pas shqyrtimit vendosi që këtë lëndë t'i caktoj kolegjit të përbërë nga dy Gjyqtarë të EULEX-it dhe një Gjyqtar vendor.

Shqyrtimi gjyqësor para këtij kolegji ishte mbajtur në mes të 15 Qershorit dhe 1 Korrik 2009. Më datën 1 Korrik 2009 kolegji shpalli dy të pandehurit fajtor për veprën penale Vrasje në bashkëpunim të E. të kryer për fitim personal - Nenit 30 Paragrafi 2 Pika 3 e LPK në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ). Bekim Zeka u dënua me njëzet (20) vjet burgim dhe Arben Zeka u dënua me pesëmbëdhjetë (15) vjet. Të dy të pandehurit u ndëshkuan me pagesë të shumës prej 10,000.00 (dhjetë mijë/00) Euro palës të dëmtuar, B., si kompensim fillestar.

Më 2 Korrik 2009 Avokati Mbrojtës Zenel Mekaj në emër të pandehurit Arben Zeka dhe më 11 Korrik 2009 Avokati Mbrojtës Abit Asllani në emër të Bekim Zeka, paraqitën ankesa kundër aktgjykimit.

Aktgjykimi me shkrim u është dhënë palëve në mes të datës 11 dhe 15 Shtator 2009.

Më 15 Shtator 2009, Avokati Mbrojtës Zenel Mekaj në emër të Arben Zekaj dhe më 27 Shtator 2009 Avokati Mbrojtës Abit Asllani përfaqësues i Bekim Zeka, paraqitën ankesa kundër aktgjykimit.

## **II. Çështjet e ngritura në ankesa:**

Avokati Mbrojtës Abit Asllani në emër të pandehurit Bekim Zeka propozoi të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Pejës dhe të shpallet klienti i tij i pafajshëm për veprën penale Vrasje të kryer në bashkëpunim për fitim personal dhe të lirohet ose në mënyrë alternative të modifikohet Aktgjykimi duke shpallur klientin e tij fajtor për Ndhimë në kryerjen e veprës penale të Vrasjes për fitim personal sipas Nenit 30 Paragrafi 2 Pika 3 e LPK në lidhje me nenin 24 të KPRSFJ dhe të ulë dënimin në përputhje me rrethanat.

Ai ankohet për aktgjykimin e shkallës së parë “për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të Ligjit Penal, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimin mbi sanksionet penale”. Megjithatë, Gjykata Supreme e Kosovës, vëren se Avokati Mbrojtës Asllani nuk dorëzon ndonjë arsyetim të ankesës së tij veçan të sfiduarit të deklaratave akuzuese të dëshmitarëve T., S., D., F. dhe G. nga pikëpamja e deklaratave të pandehurit.

Në lidhje më këtë, arsyetimi i ankesës paraqitur nga Avokati Mbrojtës Asllani mund të përmblihet me sa vijon:

- Deklarata e T. nuk është e besueshme pasi që ajo përmend se i ka harruar disa rrethana. Veç kësaj ajo ka motiv që jo realisht të fajësoj të akuzuarin Bekim Zeka i cili kishte përfunduar lidhjen me te disa kohë pas që kishte ndodhur krimi i supozuar. Kurdo që dukej te jetë e përzier në ngjarje, T. luajti rolin e viktimës duke vënë veten sa më larg vendit të krimit. Vetëm atëherë kur ishte nevoja për të akuzuar të pandehurin Bekim Zeka ajo pranoi të kishte qenë afër ndodhisë.

- Dëshmitari S. nuk ka treguar të vërtetën por ka sajuar një tregim në dobi të djalit të tij më të ri, Arbenit, duke supozuar se mund ta shpëtonte nga fajësia dhe dënimi.

- Deklarata e dëshmitarit D. nuk është e besueshme sepse dëshmitari nuk ishte në gjendje të tregonte kush ishte në shtëpi “në natën kritike” megjithëse nga njerëzit e fshatit ai “kishte dëgjuar” për ngjarjen tragjike. Deklarata e tij ishte në të shumtën sikurse recitim i mësuar përmendsh.

- Dëshmitari F. nuk kishte aspak kujtesë të besueshme çfarë edhe mund të shihet nga fakti se në shqyrtimin gjyqësor atij nuk i kujtohej deklarata e tij dhënë Prokurorit edhe pse kjo deklaratë iu lexua.

- Dëshmitari G. kishte dëgjuar “vetëm në lajme” për vrasjen e një shoferi taksie. Ai po ashtu, nuk kishte treguar të vërtetën ose në të vërtetë kishte harruar shumë gjëra nga ajo kohë pasi që harresa është veprim normal psikologjik dhe pas një periudhe aq të gjatë kohore, qenia njerëzore faktikisht ndodhë që të harroj disa gjëra.

- Dëshmitë nuk lejojnë ndonjë konkluzion kur parashtrohet pyetja se arma e kujt ishte përdorur, çfarë tipi i armës ishte dhe kush kishte gjuajtur në shoferin e taksisë duke i shkaktuar lëndime vdekjeprurëse. Sidoqoftë, nga aktgjykimi i shkallës së parë del në shesh se i akuzuari Bekim Zeka nuk ishte ai që kishte planifikuar kryerjen e krimit, të diskutonte çështjen me Arbenin ose T. dhe të godiste të ndjerin sepse nuk kishte ndonjë motiv për këtë.

Avokati Mbrojtës Zenel Mekaj në emër të akuzuarit Arben Zeka propozon të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe të liroj të akuzuarin Arben Zeka, ose të anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe kthej lëndën për rigjykim, ose ta ndryshoj atë në lidhje me vendimin mbi dënimin.

Më hollësisht, Avokati Mbrojtës pretendon:

- Faktet nuk janë vërtetuar drejt. Deklarata e dhënë nga i akuzuari Arben Zeka se ai ishte larguar dhe kishte lënë Bekimin me T. të merren me shoferin e taksisë është më e besueshme sesa versionet tjera. Vetura asnjëherë nuk është përdorur nga i akuzuari Arben Zeka, arma nuk ishte e tij, dhe uniforma të cilën e kishte të veshur T. nuk ishte po ashtu uniforma e tij. Dëshmitarja T. nuk është e besueshme sepse ishte e frikësuar se do të përfundonte në rolin e të pandehurit dhe si pasojë ja hodhi fajin Arbenit.

Veç kësaj edhe po që se i akuzuari Arben Zeka të kishte pasur marrëveshje me të akuzuarin Bekim Zeka sa i përket planifikimit të krimit ai do të kishte dobi nga koncepti i braktisjes vullnetare të kryerjes së krimit sipas (më favorizues) Nenit 22 Paragrafi 1 I Kodit Penal të Kosovës (KPK).

- Vërtetimi i gabuar i fakteve rezultojë në shkeljen e ligjit penal në dëm të akuzuarit Arben Zeka.

- Sido që të jetë, ndëshkimi që i ngarkohet të akuzuarit Arben Zeka është të ashpërsoj dhe reflekton më tepër elemente të hakmarrjes.

Zyra e Prokurorit Shtetëror të Kosovës (ZPSHK) me opinionin e datës 26 Tetor 2009, paraqet se ankesat duhet të refuzohen si të pabaza. Gjykata e shkallës së parë vërtetoi fajësinë e të akuzuarve me arsye bindëse. Me të shqiptuar dënimin gjykata e shkallës së parë vlerësoj plotësisht dhe hollësisht të gjitha rrethanat siç parashihen me Nenin 64 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK). Që të dy ankesat nuk kanë mundur të vënë në pah ndonjë rrethanë lehtësuese që do të lejonte shqiptimin e një dënim më të lehtë. Dënimet e shqiptuara nuk janë në harmoni vetëm me intensitetin e rrezikut social dhe nivelin e përgjegjësive penale por po ashtu i shërbejnë qëllimit të parandalimit të përgjithshëm.

### III. Konstatimet e Gjykatës Supreme

1.

Ankesat e Avokatëve Mbrojtës janë paraqitur me kohë dhe janë të pranueshme.

Aktgjykimi i datës 1 Korrik 2009 i është dërguar Avokatit Mbrojtës Mekaj më 11 Shtator 2009, Avokatit Mbrojtës Asllani me datë të panjohur<sup>1</sup>, dhe dy të akuzuarve më 15 Shtator 2009. Ankesa e Avokatit Mbrojtës Mekaj është paraqitur më 15 Shtator në Gjykatën e Qarkut kurse ankesa e Avokatit Mbrojtës Asllani është postuar më 27 Shtator. Pasi që në pajtim me Nenin 127 Paragrafi 4 i KPPK periudha kohore e përshkruar për të ushtruar mjet juridik duhet të filloj në datën në të cilën dokumenti i është dorëzuar të pandehurit, rezulton se që të dy ankesat janë parashtruar me kohë në pajtim me Nenin 398 Paragrafi 1 i KPPK që përcakton se një ankesë mund të parashtrohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita që kopja e aktgjykimit është dorëzuar.

---

<sup>1</sup> Data nuk mund të gjendet në fletëdërgesë.

2.

Ankesat janë të pabaza.

Të dy Avokatët mbrojtës kundërshtojnë vetëm vërtetimin e saktë të fakteve. Argumentet e paraqitura nga Avokatët mbrojtës në mbështetje të mendimeve të tyre nuk janë bindëse. Përkundrazi Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se faktet kanë qenë të përcaktuara nga Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të saktë dhe të drejtë.

Të dy ankesat kryesisht kundërshtojnë dëshminë e dëshmitares T. e cila ka qenë së bashku me të akuzuarin kur ka ndodhur krimi. Nuk është e kontestueshme që për shkak të pranisë së saj në vendin e krimit, dëshmitarja është në pozitë të vështirë pasi që mund të konsiderohet dhe mbase edhe të trajtohet si bashkëkryerëse e mundshme.

Megjithatë, vetëm kjo gjë nuk mund të shërbejë si arsye e vlefshme që tash mos t'i besohet fare. Në vend të kësaj duhet të vlerësohen me kujdes të veçantë deklaratat e saj, duke pasur gjithnjë parasysh se ajo mund të ketë ndonjë motiv që ta fajësojë pa bazë të akuzuarin në mënyrë që të shfajësojë veten.

Gjykata e shkallës së parë iu ka përmbajtur në tërësi këtyre kërkesave dhe ka vlerësuar dëshminë e dëshmitares T. me një kujdes të veçantë. Duke bërë një gjë të tillë, Gjykata e shkallës së parë ka vënë në pah se dëshmitarja T. ka pranuar se në kohën kur është kryer krimi ajo ka qenë në dijeni për qëllimin e të akuzuarit që ta privonte nga jeta viktimën.

Kjo me të drejtë është konsideruar nga Gjykata e shkallës së parë si një arsye e rëndësishme për t'i besuar asaj pasi që ajo as nuk kishte provuar të ikte nga përgjegjësia e mundshme penale e saj. Për këtë arsye, argumenti i mbrojtjes në ankesë se dëshmitarja T. "ka luajtur rolin e viktimës, duke larguar veten sa më larg vendit të krimit" nuk qëndron sepse nuk ka të bëjë fare me realitetin.

E njëjta gjë vlen edhe për gjoja "mungesën e kujtesës (së dëshmitares T.) në raste të shumta". Pikësëpari nuk guxon të injorohet fakti që dëshmitarja T. ka dëshmuar gjatë shqyrtimit gjyqësor i cili është mbajtur afërisht dhjetë (10) vjet pas kësaj ndodhie në të cilën ajo kishte qenë dëshmitare kur i kishte pasur vetëm pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Mjafton vetëm ky sqarim për mungesën e pjesshme të kujtesës dhe prandaj nuk mund të konsiderohet si arsye e mjaftueshme për ta shpërfillur plotësisht besueshmërinë e saj.

Së dyti, duhet të përmendet se dëshmitarja T., kur është përballur me deklaratat e saja të mëhershme dhe me dëshmitë e tjera, ka përmirësuar dëshminë e saj në atë masë sa që ka qenë në gjendje ta rrëfente ngjarjen penale shumë më tepër në hollësi sesa i akuzuari në përsëkrimet e tij dhe nuk ka treguar kundërshti të mëdha.

Së treti, ky rrëfim ka të bëjë me një numër hollësish të cilat plotësisht përputhen me dëshmitë e tjera, të cilat janë përshkruar në mënyrë të detajuar dhe të saktë në aktgjykimin e shkallës së parë. Në këtë kuptim, po ashtu ka rëndësi që dëshmia e saj në masë të madhe përputhet edhe me deklaratat e të akuzuarve, të cilët të dy kanë pranuar se kanë qenë në vendin e krimit, por secili prej tyre e fajëson shokun për kryerjen e krimit, duke u mbështetur në tregime të atilla të cilat nuk janë të besueshme dhe mund të jenë gjithçka tjetër vetëm jo bindëse.

Duke u nisur nga kjo gjithashtu përjashtohet mundësia që dëshmitarja T. kishte motiv për ta fajësuar pa të drejtë të akuzuarin Bekim Zekën për shkak se ai i kishte dhënë fund marrëdhënies me të pak kohë pas kësaj ndodhie.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka dështuar pra që me kujdes të vlerësojë edhe këtë çështje dhe motivin e tillë për fajësim pa të drejtë e ka përjashtuar me arsyetimin e tyre të plotë. Duke bërë një gjë të tillë duke theksuar se dëshmitarja T. nuk e ka fajësuar vetëm Bekim Zekën por edhe Arben Zekën, gjë e cila e bën këtë pretendim të mbrojtjes të pambështetur.

Si rezultat i kësaj nuk ka dyshim se krimi ka ndodhur ashtu siç është konstatuar nga Gjykata e shkallës së parë, duke u mbështetur në dëshminë e dëshmitares T..

Argumentet e tjera në ankesa kanë të bëjnë me dëshmitarët që bazohen në vetëm thashetheme dhe jo në vrojtimitet e tyre lidhur me kryerjen e krimit. Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës mban qëndrimin se argumentet e ngritura në ankesa kundër besueshmërisë së këtyre dëshmitarëve dhe vlerësimit se dëshmitë e tyre bazohen thjesht në spekulime prandaj këto pohime janë pa kurrfarë substance. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar në tërësi dhe në hollësi dëshmitë e këtyre dëshmitarëve dhe ka sqaruar në mënyrë bindëse dhe të qartë se këto fakte janë konstatuar pa asnjë dyshim.

Gjykata Supreme e Kosovës nënvizon se paaftësia e Gjykatës së shkallës së parë për ta përcaktuar pronarin e armës e cila është përdorur për ta qëlluar viktimën, nuk e bën vërtetimin e fakteve të gabueshëm apo jo të plotë. Po ashtu nuk është e rëndësishme që nuk ka pasur mundësi të përcaktohet lloji i armës së përdorur nga i akuzuari.

Është konstatuar pa asnjë dyshim se viktimja është qëlluar dhe është vrarë me revole, ndërsa hollësitë e tjera për këtë armë si – marka, prodhimi, pronësia – nuk janë elemente të veprës penale të vrasjes së rëndë sipas Nenit 30, paragrafit 2 të LPK-së. Prandaj, nuk mund të bëhet vërejtje se gjendja e dëshmive nuk ka mundësuar konstatimin e detajeve të revoles. E njëjta vlen edhe për çështjen se cili prej të akuzuarve ka mbajtur revolen në dorë kur është shkrepur e shtëna vdekjeprurëse. Konstruktimi juridik i bashkëkryerjes sipas Nenit 22 të KP të RSFJ-së nuk kërkon elementet objektive të krimit të kryera veç e veç nga secili prej të pandehurve. Në vend të kësaj kërkohet qëllimi i secilit prej të pandehurve për të

kryer veprën penale dhe, duke u bazuar në këtë qëllim, pranimi i veprave të bashkëkryerësve të tjerë si vepra të tyre. Rrjedhimisht në aspektin ligjor nuk ka rëndësi nëse revolja është mbajtur dhe është shkrepur nga i akuzuari Arben Zeka apo nga i akuzuari Bekim Zeka. Duke u bazuar në këtë nuk ka hapësirë për cilësim juridik sipas të cilit njëri nga të akuzuarit ka vepruar vetëm si ndihmës i tjetrit.

Përkitazi me caktimin e dënimit, Gjykata Supreme konstaton se Gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka caktuar dënimet me burgim për të akuzuarit.

Ligj i zbatueshëm në përgjithësi është ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së krimit. Megjithatë, pasi që Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK) ka hyrë në fuqi pas kryerjes së krimit, atëherë gjykata, në përputhje me Nenin 2 të KPPK-së duhet që të zbatojë ligjin më të favorshëm.

Vlerësimi se cili ligj është më i favorshëm nuk mund të bëhet *in abstracto* duke u bazuar në pikat e aktakuzës. Gjykata Supreme ka sqaruar tashmë në vendimet e mëhershme<sup>2</sup> se ekzistojnë disa rregulla të cilat i shtohen parimit të ligjit më të favorshëm. Megjithatë, në rend të parë,

“duhet që të theksohet se krahasimi i ‘ashpërsisë’ ndërmjet ligjit të ri dhe atij të vjetër nuk bëhet lidhur me ato dy ligje (ose dispozita specifike) të marra *in abstracto*, por gjithmonë përkitazi me epilogun e zbatimit të këtyre ligjeve në rastin konkret. Pasoja praktike është se vepra duhet patjetër të vlerësohet në aspektin gjyqësor sipas ligjit të vjetër dhe sipas atij të riut, dhe pastaj rezultatet të krahasohen. Po qe se rezultati për të akuzuarin është i njëjtë edhe sipas ligjit të vjetër edhe sipas të riut (...), KPPK-ja parasheh që të zbatohet ligji i vjetër”<sup>3</sup>.

Në rastin në fjalë, ligj i zbatueshëm në kohën kur është kryer krimi – diku kah fundi muajit qershor 1999 – ka qenë Neni 30, paragrafi 2 i LPK-së i cili përcakton si dënim burgim prej së paku dhjetë (10) vjetësh burgim ose dënim me vdekje. Dënimi kapital është hequr me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59, Neni 1.5.

Prandaj, dënimi maksimal i mundshëm ka qenë burgimi prej pesëmbëdhjetë (15) vjetësh burgim sipas Nenit 38, paragrafit 1 të KP të RSFJ-së ose njëzet (20) vjet burgim sipas Nenit 38, paragrafit 2 të KP të RSFJ-së. Çështja nëse Neni 38, par. 2 i KP të RSFJ-së ka qenë ligj i zbatueshëm në Kosovë apo jo, nuk ka nevojë të sqarohet në këtë fazë, sepse dispozita përkatëse e Nenit 147 të KPPK-së/KPK-së përcakton si dënim burgimin prej së paku dhjetë (10) vjetësh ose burgimin afatgjatë deri në dyzet (40) vjet, prandaj në asnjë rast nuk është ligj më i favorshëm për të akuzuarit.

<sup>2</sup> AP - Kž. Nr. 382/2003; AP – Kž. Nr. 368/2009

<sup>3</sup> Shih po ashtu edhe Gjykata Supreme e Kosovës, AP KZ 490/2003

Kështu, ligj i zbatueshëm në këtë rast është LPK-ja dhe në veçanti Neni 30, par. 2 i LPK-ë, ashtu siç është konstatuar me të drejtë edhe nga Gjykata e shkallës së parë.

Edhe pse Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në zbatimin e këtij ligji, me të drejtë ka marrë të drejtën që të akuzuarve t'u shqiptojë dënim me burgim deri në njëzet (20) vjet, arsyetimi juridik kërkon një sqarim më të hollësishëm.

Dënimi minimal me burgim prej dhjetë (10) vjetësh del nga Neni 30, par. 2 i LPK-së dhe nuk vjen në shprehje. Përcaktimi i dënimit maksimal, megjithatë, kërkon një analizë më të thukët të dispozitave ligjore. Neni 38, par. 1 i KP të RSFJ-së si rregull e përgjithshme kufizon dënimin më të lartë të mundshëm në pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim.

Duke iu shmangur kësaj rregulle, paragrafi 2 i nenit të njëjtë lejon dënimin me burgim prej njëzet (20) vjetësh për vepra penale për të cilat parashihet dënimi me vdekje. Ky paragraf i nenit 38 të KP të RSFJ-së, megjithatë, nuk zbatohet drejtpërdrejt në rastin në fjalë. Edhe pse Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/1 ka përcaktuar si ligj të zbatueshëm në territorin e Kosovës “ligjin që ka qenë në fuqi para datës 24 mars 1999”, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 ka përcaktuar si ligj të zbatueshëm “ligjin që ka qenë në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989”.

Pasi që paragrafi 2 i Nenit 38 të KP të RSFJ-së është zbatuar me Ligjin mbi ndryshimet e KP të RSFJ-së të datës 26 korrik 1993<sup>4</sup>, ai ka hyrë në fuqi pas datës 22 mars 1989 dhe nuk ka qenë i zbatueshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, gjë e cila bazuar në parimin e ligjit më të favorshëm duhet të respektohet në raport me të akuzuarin.

Ndryshimi i mëvonshëm i ligjit përmes nenit 1.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/59 – dënim i mundshëm me burgim maksimal prej dyzet (40) vjetësh për veprat penale të cilat dënohen me dënim me vdekje – nuk mund të zbatohet në rastin në fjalë pasi që do të rezultonte në zbatimin e ligjit të ndryshuar në dëm të të akuzuarit.

Megjithatë, në rastin në fjalë Neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 lejon zbatimin e jashtëzakonshëm të Nenit 38, paragrafit 2 të KP të RSFJ-së. Ky Nen përcakton si më poshtë:

*Nëse gjykata ose organi apo personi kompetent ka kërkuar të zbatohet një dispozitë e ligjit, konstaton se një çështje apo situatë e caktuar nuk mbulohet me ligjet e përcaktuara me nenin 1.1 të kësaj rregulloreje por mbulohet me ndonjë ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas datës 22 mars 1989, i cili nuk është diskriminues dhe që është në*

---

<sup>4</sup> Shih Ljubisa Lazarevic, Komentim i Kodit Penal të RFJ-së, 1995, botimi i 5<sup>të</sup>, Neni 38, paragrafi 2, pjesa 2

*pajtim me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi apo personi përjashtimisht e zbatojnë atë ligj.*

Bazuar në këtë rregull përjashtuese, Neni 38, paragrafi 2 i KP të RSFJ-së mund të zbatohet për veprat penale të kryera në territorin e Kosovës pas datës 22 mars 1989. Është e qartë se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24, kur e ka shfuqizuar dënimin me vdekje, nuk ka mbuluar çështjen e zëvendësimit të tij me dënim me burgim që kalon dënimin maksimal prej pesëmbëdhjetë (15) vjetësh burgim.

Në kuptimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/59, nuk mund të arsyetohet që zëvendësimi i këtillë nuk është parë i nevojshëm sepse Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/59 ka hequr dënimin kapital (Neni 1.5), kësaj radhe duke e zëvendësuar dënimin kapital me burgim të mundshëm deri në dyzet (40) vjet.

Çka është më e rëndësishme është se sipas Nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/59, ky ndryshim konsiderohet të ketë hyrë në fuqi që nga data 10 qershor 1999. Edhe pse kjo automatikisht ngre pyetje ligjore përkitazi me efektin ligjor retroaktiv, tregon qartë idenë e organeve ligjberëse në territorin e Kosovës që zëvendësimi për dënimin e shfuqizuar kapital është dashur tashmë të përcaktohet në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24. Pasi që paragrafi 2 i Nenit 38 të KP të RSFJ-së nuk është as diskriminues as në kundërshtim me parimet e përmendura në Nenin 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, atëherë përjashtimisht lejohet zbatimi i tij.

Rrjedhimisht kufiri i dënimit për të akuzuarin shtrihet nga dhjetë (10) deri në pesëmbëdhjetë (15) apo dënim i fiksuar prej njëzet (20) vjetësh burgim. Dënimet e shqiptuara nga ana e Gjykatës së shkallës së parë janë brenda këtij kufiri.

Edhe dënimet individuale me burgim të shqiptuara kundër të akuzuarit po ashtu janë të drejta. Gjykata e shkallës së parë ka caktuar dënimin konkret duke marrë parasysh hollësisht edhe rrethanat lehtësuese edhe ato rënduese.

Argumenti i Avokatit mbrojtës Asllani se fakti që klienti i tij Bekim Zeka ka qenë luftëtar i UÇK-së për dy vjet ka mund ta diktojë kryerjen e krimit nuk qëndron. Avokati mbrojtës Asllani nuk ka dhënë asnjë arsye specifike apo rrethana të cilat do të mund të shpinin tek një konstatim i këtillë.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart, këto ankesa refuzohen si të pabaza ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë vërtetohet në tërësi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**AP – KŽ. Nr. 365/2009**

**Kryetari i kolegjit**

*Norbert Koster*

**Anëtare e kolegjit**

*Maria Giuliana Civinini*

**Anëtar i kolegjit**

*Martti Harsia*

**Anëtare e kolegjit**

*Emine Kaçiku*

Republika e Kosovës



Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETËN  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

**Anëtare e kolegjit**

*Emine Mustafa*  
Punëtorja  
Ovlašçerë radnik

